



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 44 Prot.

Tiranë, më 21 / 06/2024

UDHËZIM

Nr. 2, datë 21/06/2024

PËR

VLERËSIMIN E FLETËVE TË VOTIMIT TË HEDHURA NË KUTITË E GABUARA

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Rregulloren ”Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024 – 2028, në Universitetin Politeknik të Tiranës”, neni 6, pika 2, si dhe bazuar në vështirësitë e konstatuara gjatë procesit të votimit për identifikimin sipas ngjyrave të kutive përkatëse të fletëve të votimit, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,

UDHËZON:

1. Fletët e votimit të hedhura në kutinë e gabuar të konsiderohen si vota të vlefshme, përveç rasteve kur fleta paraqet elemente të cilat e bëjnë të pavlefshme sipas nenit 37, pika 5 të Rregullores së Zgjedhjeve.
2. Gjatë procesit të numërimit të votave për secilën kuti, fletët që gjenden në kutinë e gabuar futen, të pa hapura (të palosura), në “Zarfin e fletëve të votimit të hedhura në kutinë e gabuar”.
3. Fletët e hedhura në kutinë e gabuar shënohen në procesverbal të veçantë, duke specifikuar numrin për secilën kuti dhe për secilën kategori flete.
4. Pas procesit të numërimit të të gjitha kutive, Komisioni hap, vlerëson dhe numëron fletët e hedhura në kutinë e gabuar për secilën tipologji flete dhe nëse rezultojnë të vlefshme, sasitë e tyre shtohen në tabelën përmbledhëse të rezultateve. Zarfi me fletët e votimit të hedhura në kutinë e gabuar futet në kutinë e votimit për Rektorit.
5. Ngarkohen KZF-të për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëhere.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Edmond PERGEGA

Kryetar



Alfred PJETRI

Anëtar

Albina BASHOLLI

Anëtar

Anjeza DULAJ (GJINI)

Anëtar




Nelda KOTE

Anëtar



Irida GJOKA (MARKJA)

Anëtar




Klajdi QOSHI

Anëtar



Pietro BELBA

Anëtar



Lidia HYSA

Anëtar

